



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.177/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në përbërje nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 05.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje dega në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP me të cilën pretendon se rreth orës 14:05 aktivistët e tyre kanë vërejtur se mbi rrugën “De Rada” në Prizren, është vendosur poster i kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Haziz Hodaj nga radhët e subjektit politik LDK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e nenit 4 paragrafi 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe 120 paragrafi 1 pika a) të LZP, subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e informoi dhe Urdhëroi që të ndërmarr masat përmirësuese lidhur me ankesën e datës 05.06.2014, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankesë deri më datë 06.06.2014 në ora 17:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK në të cilën deklaroi se shtabi zgjedhor i LDK-së ka ndërmarrë masa përmirësuese duke e larguar banerin e kandidatit të tyre.

Përgjigjes në ankesë ia ka bashkangjitur fotografinë me të cilën dëshmohet veprimi i largimit të posterave nga vendi që është bërë shkelja e pretenduar në ankesë PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se poster i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik LDK Haziz Hodaj është vendosur mbi rrugë publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-

së e cila dispozitë juridike përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe ato lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik LDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik LDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik LDK është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit të saj janë të vendosura mbi rrugë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik LDK që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.177 /2014 më datën 08.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.